



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 10/1 Prot.

Tiranë, më 05 . 01 . 2022

V E N D I M

Nr. 1, Datë 05 . 01 . 2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 119, datë 21.06.2021¹, të bërë nga B.V, i përfaqësuar me autorizim nga Shoqata “Për Drejtësi Sociale”² kundër Këshillit të Ministrave (KM), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkisë Pogradec, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”³, “gjendjes ekonomike dhe shëndetësore”⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, dhe me e-mail-in datë 28.06.2021, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me shkresën nr. 3096/10, datë 10.10.2018 të MIE-s, është njoftuar se do të shpronësohej për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila prekej nga realizimi i projektit: “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”, si më poshtë: - Zonë kadastrale nr. 8582, Tokë truall me sipërfaqe 11.7 m² x 10491=122.745 lekë; - Ndërtesë me sipërfaqe 46.8 m² x 49900=2.335.320 lekë. B.V për shkak të sëmundjes dhe kushteve të këqija të banesës ka depozituar shkresën, të protokolluar pranë bashkisë me nr. 5276, datë 22.10.2020, në të cilën ka kërkuar nga bashkia, leje për të

¹ Ankesa është plotësuar me informacion dhe dokumentacion, me e-mail-in datë 28.06.2021.

² Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, e regjistruar me Vendimin nr. 6599, datë 14.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përfaqësuese me autorizim, i B.V.

³ Referuar Vërtetimit datë 14.06.2021 të Shoqatës “Qëndistarët”, B.V është anëtar i komunitetit egjiptian.

⁴ Referuar Vërtetimit datë 11.06.2021 të Bashkisë Pogradec, Sh.V (motra) dhe B.V trajtohen me ndihmë ekonomike si persona me aftësi të kufizuara, ndërsa A.V (bashkëshortja) trajtohet me ndihmë ekonomike si kujdestare e Sh.V.

rikonstruuar banesën e tij, për shkak të amortizimit që ka pësuar. Bashkia Pogradec me shkresën nr. 5276/1, datë 12.11.2020 i është përgjigjur ankuesit se banesa e tij është pjesë e projektit të shpronësimeve të objektit “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Pllocë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”. Ankuesi informon se dhe pas tre viteve që është bërë njoftimi akoma nga Këshilli i Ministrave nuk është miratuar vendimi për shpronësimin e pasurisë së familjes B.V, e cila vazhdon të jetojë në një ambient që i ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të tij dhe të motrës së tij. Gjithashtu, banesa e B.V nuk përfitoi dhe nga rikonstruksioni që ju bë ndërtesave të bllokut të pallateve përreth me fondet e MFE-s, me arsyen se banesa do të shpronësohej. Ankuesi informon se, Bashkia Pogradec duke ditur situatën e familjes B.V e ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë, në krahasim me familjet e tjera, lidhur me kërkesën për rikonstruksionin e banesës”.

Subjekti ankues, kërkon⁵ nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Pogradec.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë

⁵ Referuar e-mail-it datë 28.06.2021.

një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 119, datë 21.06.2021, të paraqitur nga Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 943/1, datë 30.06.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga KM, MIE, Bashkia Pogradec dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me shkresën nr. 198/2, datë 05.07.2021, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, informoi Komisionerin se: “Procedura e shpronësimit është miratuar nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit dhe me shkresën nr. 5643, datë 27.07.2020, MIE i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) për mendim. MFE me shkresën nr. 14473/1, datë 10.08.2020, ka sugjeruar që efekti financiar i shpronësimit të mbulohet nga buxheti i miratuar për MIE, në zërin dedikuar shpenzimeve për shpronësime. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE, në përgjigje të shkresës tonë nr. 24/11, datë 24.11.2020, është shprehur se, në buxhetin e vitit 2020, nuk ka fonde të planifikuara për përballimin e efektit financiar për procedurën e shpronësimit të sipërcituar. Për sa më sipër, MIE me shkresën nr. 5643/3, datë 12.11.2020, i është drejtuar Bashkisë Pogradec për mbulimin e fondit të shpronësimit, e cila në kthimin e përgjigjes bën me dije se në buxhetin e vitit 2021 nuk ka planifikuar fondet për shpronësimet. Me miratimin e fondeve për shpronësim, projektvendimi do dërgohet për miratim në KM”.

Me shkresën nr. 2259/1, datë 05.07.2021, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), informoi Komisionerin se: “FSHZH është një Agjenci Zbatuese e cila ushtron veprimtarinë e saj në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës, urbanizimit dhe turizmit. FSHZH mbështet kërkesat për

investim nga Njësitë Vendore (Bashkitë) në të gjithë vendin në projektet e tyre përmes financimit apo procesit të zbatimit. Në këtë kuadër FSHZH me marrjen e kërkesës për bashkëpunim nga Bashkia Pogradec ka zbatuar punimet për objektin “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Pllocë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”. Për këtë ndërhyrje FSHZH me datë 17.01.2017 ka nënshkruar Marrëveshje Investimi (MI) me Bashkinë Pogradec, ku ndër të tjera specifikohet se Bashkia ka përgjegjësinë për të ndjekur dhe trajtuar procesin e shpronësimeve, si dhe problematikat juridike/sociale të banorëve të ndikuar nga projekti. FSHZH nuk ka kompetencë, detyrim për trajtimin e çështjeve të mësipërme ligjore në raport me palët e treta, të përfshira në zonën ku janë zhvilluar apo janë në proces ndërhyrjet infrastrukturore”.

Me shkresën nr. 264/1, datë 12.07.2021, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH), informoi Komisionerin se: *“Referuar kërkesës të paraqitur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të cilën MIE e ka përcjellë për kompetencë në ASHSH, bëjmë me dije se, me shkresën nr. 4511, datë 31.05.2021, të Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve (bashkëlidhur) dosja për shpronësimin e pasurive që preken nga projekti “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Pllocë-Hyrja Pogradec dhe Rruga Unazë”, i është kthyer pa veprim Bashkisë Pogradec, për mungesë dokumentacioni dhe saktësim të të dhënave, bazuar në nenin 12 “Kthimi pa veprim dhe refuzimi i kërkesës”, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, i ndryshuar, ku në listën për shpronësim ka qenë e përfshirë pasuria nr. 17/127+1-2/3, zk. 8582, në pronësi të bashkëpronarëve B.V”.*

Me shkresën nr. 3023/2, datë 13.07.2021, Bashkia Pogradec, informoi Komisionerin se: *“Objekti “Sistemim asfaltim i aksit rrugor “Qafë Pllocë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”, ka përfunduar (është kolauduar dhe është marrë në dorëzim). Për të vazhduar procesin e shpronësimeve i kemi kërkuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit projektin e shpronësimeve sipas të cilit është realizuar ky objekt (fizike dhe CD, AutoCad). Theksojmë se kjo kërkesë ka qenë e përsëritur dhe momentalisht projekti i shpronësimeve nuk na është vënë në dispozicion. Gjithashtu, gjatë procedurës së shpronësimit nuk kemi bërë evidentime lidhur me etnicitetin e personave që preken nga procedura e shpronësimit”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 119, datë 21.06.2021, Komisioneri me shkresën nr. 1270, datë 09.09.2021 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 20.09.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces si dhe kërkoi informacion dhe dokumentacion, si më poshtë:
 - Korrespondencën e plotë të MIE me Bashkinë Pogradec dhe B.V, lidhur me shpronësimin e pasurisë së B.V dhe të personave të tjerë të prekur nga projekti: *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Pllocë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”.*

- Korrespondencën e plotë të Bashkisë Pogradec me B.V, lidhur me shpronësimin publik të pasurisë dhe kërkesës së tij për rikonstrukcionin e banesës.
- Informacion mbi fazën, në të cilën ndodhet procesi i shpronësimit publik të ankuesit dhe të personave të tjerë, si rrjedhim i zbatimit të projektit: *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Pllocë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”*.
- Kopje të Marrëveshjes së Investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Pogradec, datë 17.01.2017 për objektin: *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Pllocë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”*.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: përfaqësuesit të subjektit ankues, G.S dhe palës së ftuar në seancë, përfaqësueses me autorizim të ASHSH-së, D.D, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Asistencës Ligjore. Me e-mail-in datë 09.09.2021, M.C me detyrë Koordinatore e Njësisë Ligjore dhe Koordinimit të Nismave Prioritare dhe e Acquis të Kryeministrit, informoi se Këshilli i Ministrave ka të njëjtin qëndrim me ASHSH-në. Bashkia Pogradec dhe MIE, nuk u paraqitën në seancë.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Përfaqësuesi i subjektit ankues në parashtrimet e tij, në mes të tjerash deklaroi⁶ se: *“B.V është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në krahasim me qytetarë të tjerë që disponojnë pronë dhe kanë të drejtë që të kryejnë veprime apo të përmirësojnë banesat e tyre. Periudha shumë e gjatë e procesit të shpronësimit, është një situatë diskriminuese pasi nuk i jep asnjë mbrojtje ligjore si qytetar i cili ndodhen në këtë situatë dhe për shkak të zvarritjes së shpronësimit, nuk ka mundësi të rikonstruktojë banesën dhe të krijojë kushte më të mira jetese. B.V ka kërkuar që të rikonstruktohet banesa me projektin që ishte duke u zbatuar nga bashkia, por që mori përgjigje negative për shkak se ishte në proces shpronësimi”*.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e ASHSH-së i qëndroi parashtrimeve të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe informoi⁷ se ASHSH gjatë shqyrtimit të dosjes ka vërejtur mangësi në dokumentacion, ka kërkuar plotësimin e dosjes dhe nuk ka bërë shpronësim për asnjë pronar të listës së depozituar nga bashkia. Bashkia Pogradec nuk mund të veprojë pa ndodhur procesi i shpronësimit dhe se nuk ka të parashikuar ndonjë afat për procesin e shpronësimit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, nga ana e institucionit të Komisionerit u la si detyrë ASHSH-së që të dërgonte informacion, nëse ka pasur ankesa nga palë të treta apo kundërshtime nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, lidhur me procesin e shpronësimit të pronës së B.V.

⁶ Referuar min 05.30 e në vijim të seancës dëgjimore

⁷ Referuar min 15.20 e në vijim të seancës dëgjimore.

Me shkresën nr. 920/1, datë 29.09.2021, ASHSH në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “ASHSH është funksionale dhe operon duke filluar nga muaji Janar 2021, në respektim dhe në zbatim të VKM nr. 395, datë 13.05.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASHSH”. Lidhur me këtë procedurë shpronësimi sqarojmë se, në nenin 7, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Objekte të shpronësimit janë pasuritë e paluajtshme në formën e tokës, të ndërtimeve të çdo lloji, me karakter të përhershëm, pasuritë e luajtshme të treguara në shkronjat “e” dhe “ë”, të nenit 8, të këtij ligji, kulturat bujqësore, si dhe çdo investim tjetër i trupëzuar në tokën bujqësore, që do të shpronësohet”. Gjithashtu, në germën “e”, të pikës 1, të nenit 10 të ligjit të sipërcituar, parashikohet se: “1. Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: e) Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës”. Në respektim të dispozitave të sipërcituara, si dhe në tërësi të legjislacionit për shpronësimet dhe teknikës legjislative, miratimi i shpronësimit për realizimin e një projekti, bëhet me anë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave ku përfshihen të gjithë pronat që preken nga realizimi i këtij projekti. Rjedhimisht, për realizimin e procesit të shpronësimit, me qëllim realizimin e një projekti, subjekti kërkues duhet të paraqesë një kërkesë për shpronësim, sipas parashikimeve të nenit 10, të ligjit 8561/1999, i ndryshuar, ku të jenë të përfshira të gjitha pasuritë, pronë e paluajtshme që preken nga realizimi i projektit përkatës. Ndërkohë, nga Bashkia Pogradec, janë paraqitur pranë MIE-es, disa kërkesa të ndryshme me objekte të ndryshme, madje në periudha kohore të ndryshme edhe pse kërkohet shpronësimi i pronave private, për realizimin e projektit “Sistemim asfaltim i aksit “Qafë Plloçë-Pogradec dhe Unaza Pogradec”. Në rastin konkret, Bashkia Pogradec, ka paraqitur kërkesë më vete për pasurinë “Ndërtesë”, kërkesë tjetër për pasurinë “Truall”, si dhe kërkesë tjetër për llojin “Tokë arë dhe pemëtore”, veprime të cilat nuk janë kofrom dispozitave të sipërcituara. Konkretisht, përsa i përket kërkesës për shpronësim për këtë projekt, ju sqarojmë se: subjekti kërkues, ka dërguar fillimisht, kërkesën për shpronësim për interes publik me nr. 3288, datë 14.09.2019, për projektin “Sistemim asfaltim i aksit Qafë Plloçë-Pogradec dhe Unaza Pogradec”. MIE në cilësinë e organit kompetent për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, gjatë kohës që është paraqitur kërkesa për shpronësim, me Urdhrin nr. 79, datë 11.10.2017, ka ngritur Komisionin e Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga projekti i sipërcituar. Në vijim, Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e dërguar nga subjekti kërkues, pasi ka konstatuar disa mangësi, ka kërkuar plotësime, si dhe sqarimet e duhura me anë të shkresës nr. 4654/1, datë 01.12.2017, me lëndë “Plotësim Dokumentacioni” drejtuar Bashkisë Pogradec. Gjatë ndjekjes së hapave të mëtejshme për zhvillimin e procedurës së shpronësimit, Bashkia Pogradec me anë të shkresës nr. 591, datë 13.02.2018, ka dërguar një kërkesë të re për

shpronësim për interes publik për objektet “ndërtesë”, për të njëjtin projekt shpronësimi (Sistemim asfaltim i aksit Qafë Plloçë-Pogradec dhe Unaza Pogradec). Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, duke marrë në konsideratë se, Bashkia Pogradec ka paraqitur të njëjtën kërkesë, pasi bëhet fjalë për të njëjtin projekt, ka vijuar me procedurat e shpronësimit, për projektin në fjalë duke shqyrtuar dokumentacionin e dërguar nga subjekti kërkuar. Në vijim të korrespondencave të mbajtura mes MIE dhe Bashkisë Pogradec, me qëllim realizimin e këtij shpronësimi, me shkresën nr. 3096/l, datë 21.06.2018, Komisioni i Posaçëm ka kërkuar plotësim dokumentacioni, lidhur me pasuritë e prekura, dhe në përgjigje të kësaj kërkesë Bashkia, me shkresën nr. 59113, datë 13.07.2018, ka dërguar plotësimet e dokumentacionit të kërkuar për shpronësimin në interes publik për objektet “ndërtesë”. Ndërkohë, Bashkia Pogradec, në cilësinë e subjektit kërkuar me shkresën nr. 6937, datë 20.09.2018, ka ridërguar “Plotësim kërkesë për shpronësim në interes publik në vazhdimësi”, pranë MIE-s. Pas kësaj faze, subjekti kërkuar ka plotësuar mangësitë e dokumentacionit të konstatuara nga Komisioni i Posaçëm, duke vijuar më tej me ndjekjen e procedurave të shpronësimit, konkretisht me “Njoftimin e pranimit të kërkesës”, si dhe me publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, nr. 145, datë 11.10.2018, ku në listën bashkëlidhur, rezultojnë të përfshirë dhe bashkëpronarët B.V, për pasurinë me objekt truall/ndërtesë nr. 17/127+1-2/3 ZK 8582. Bazuar në këtë publikim, është vijuar me njoftimin e qytetareve, dhe konkretisht, bashkëpronarët B.V janë njoftuar me shkresën nr. 3096/10, datë 10.10.2018. Në vijim të këtij publikimi, midis MIE dhe Bashkisë Pogradec, rezulton e lidhur Akt-Marrëveshja, protokolluar në MIE me nr. 12597, datë 10.10.2018, dhe protokolluar në Bashkinë Pogradec me nr. 7798, datë 25.10.2018, nëpërmjet të cilës përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, për efekt të realizimit të këtij projekti. Lidhur me këtë Akt-Marrëveshje mes institucioneve, sqarojmë se ky akt është lidhur vetëm për efekt të realizimit të kërkesës fillestare për shpronësim, konkretisht kërkesa me nr. 3288, datë 14.09.2017, “Sistemim asfaltim i aksit Qafë Plloçë-Pogradec dhe Unaza Pogradec”, duke mos përfshirë kërkesat e reja për shpronësim, që kanë ardhur më pas, në vijim të procedurave të shpronësimit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dosjes së shpronësimit, rezulton se, në datë 07.11.2018, Bashkia Pogradec ka paraqitur pranë MIE-s një kërkesë të re, me anë të shkresës nr. 6937/1, datë 07.11.2018, me lëndë: “Plotësim kërkesë për shpronësim në interes publik në vazhdimësi “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”, për objektin “truall”. Sqarojmë se, në shkresën e sipërcituar janë cilësuar të dhëna të reja mbi kërkesën për shpronësim të paraqitur fillimisht për projektin “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”, pasi është shtuar objekti i ri mbi pasuritë që preken nga shpronësimi, konkretisht objekti “truall”, gjithashtu Bashkia Pogradec, për të njëjtin projekt ka kërkuar shpronësimin e disa pasurive të tjera të cilat nuk ishin pasqyruar në kërkesën e paraqitur fillimisht në MIE. Pas kësaj korrespondence mes MIE dhe Bashkisë Pogradec lidhur me ecurinë e procesit të shpronësimit, Komisioni i Posaçëm me anë të disa shkresave ka kërkuar nga Bashkia Pogradec plotësimet për dokumentacionet që kanë pasur mangësi, për të cilat Bashkia ka dërguar disa plotësime, ku më pas Komisioni i ka shqyrtuar dhe ka konkluduar përsëri në disa mangësi. Me qëllim përsheptimit e procedurave të shpronësimit, duke qenë se nga ana e Bashkisë, ka pasur vonesa në dërgimin e dokumentacionit plotësues, MIE me shkresën nr. 1425/3, datë 08.10.2019, ka

vënë në dijeni subjektin kërkues se: “Vonesat në plotësimin e dokumentacionit përbëjnë shkak për kthimin e dosjes së shpronësimit dhe refuzimin e kërkesës për shpronësim”. Ndërkohë, pavarësisht sa më sipër, rezultoi se, Bashkia Pogradec me anë të shkresës nr. 395/1, datë 27.01.2020, me lëndë “Kërkesë për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private të Ç.C, ka depozituar një kërkesë të re shpronësimi, për pasurinë e llojit “Tokë arë dhe pemëtore”, për të njëjtin projekt “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”. Në vijim të shqyrtimit të kësaj dosje, e cila në përbërje të saj mbart disa kërkesa të ndryshme për shpronësim, për të njëjtin projekt, Komisioni i Posaçëm i ngritur me urdhrin e Ministrit nr. 79, datë 11.10.2017, të pasuara edhe me disa ndryshime, në strukturën e sektorit të shpronësimeve, konkretisht me krijimin e ASHSH, bazuar në VKM nr. 395, datë 13.05.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASHSH”, ka mbajtur me datë 27.05.2020, një procesverbal: “Lidhur me disa mangësi të përsëritura, për të cilat me shkresën nr. 4189, datë 03.06.2020 me lëndë “Kthim Përgjigje”, dhe në vijim i është drejtuar Bashkisë Pogradec, duke i cilësuar që të bëhen të gjitha reflektimet e duhura në tabelën e shpronësimit, sipas rekomandimeve përkatëse, me qëllim vazhdimin e procedurave të shpronësimit. Bashkia Pogradec me shkresën nr. 2481/1, datë 07.07.2020, ka paraqitur plotësimet për një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe Komisioni pas vlerësimit të përgjigjes ka konstatuar përsëri mangësi në dokumentacion, dhe me shkresat nr. 4189/2, datë 10.09.2020 dhe nr. 1750, datë 12.02.2021, ka kërkuar plotësim dokumentacioni. Sa më sipër sqarohet se, korrespondenca nga MIE dhe ASHSH, ka qenë disa herë e përsëritur, e rregullt dhe brenda afateve ligjore, të cilat dokumentohen me anë të shkresave të lartpërmendura dhe me qëllimin e vetëm, realizimin e projektit për të cilin është paraqitur kërkesa për shpronësim nga Bashkia Pogradec. Sa më sipër, Komisioni i Posaçëm, duke hasur mangësi të herëpashershme lidhur me plotësimet e dokumentacioneve, me shkresën nr. 4511, datë 31.05.2021 “Kthimin e kërkesës për shpronësimin dhe dokumentacionit shoqërues, për kërkesën e parë për shpronësim të dërguar nga Bashkia Pogradec nr. 3288, datë 14.09.2017”, me arsyetimin se nga ana e kësaj të fundit nuk është dërguar dokumentacioni i kërkuar sipas parashikimeve ligjore bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 12, të ligjit 8561/1999, të ndryshuar. Në vijim, lidhur me këtë procedurë, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, ka proceduar me kthimin e kërkesës për shpronësim për të gjitha kërkesat e tjera të shpronësimit për këtë projekt dhe dokumentacionin shoqërues, konkretisht me shkresën nr. 320, datë 23.07.2021, të cilat për efekt procedimi, janë dërguar pranë Bashkisë Pogradec. Arsyetimi i kthimit të kësaj dosje shpronësimi, është argumentuar si vijon, në mbështetje të ligjit të shpronësimeve, nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, dhe teknikës legislative, ku për realizimin e një projekti duhet të dalë një Vendim i vetëm i Këshillit të Ministrave, bazuar në një kërkesë të vetme shpronësimi, ku të përfshihen në dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës, të gjitha llojet e objekteve që preken nga projekti i shpronësimit qofshin këto të llojit “truall”, “ndërtesë” apo “tokë arë dhe pemëtore”, vlerësimi i të cilave bëhet sipas akteve ligjore përkatëse. Në kushtet e mësipërme, procesi i shpronësimit për këtë projekt nuk është finalizuar me daljen e një Vendimi nga Këshilli i Ministrave dhe kërkesa për shpronësim e Bashkisë Pogradec, është kthyer pa veprim. Rrjedhimisht, përderisa kërkesa për shpronësim për këtë projekt nuk është miratuar, nuk ka ndodhur asnjë pasojë juridike mbi pronarët, pronat e të cilëve ishin parashikuar për tu shpronësuar”.

- Në vijim të procedurës për shqyrtimin e ankesës, si dhe në zbatim të Urdhërit nr. 148, datë 08.10.2021 të Komisionerit, me datë 19.10.2021, u realizua inspektimi në Bashkinë Pogradec. Inspektimi kishte si objekt të tij, marrjen e informacionit të drejtëpërdrejtë nga institucioni si dhe dokumentacionin shkresor përkatës.

Gjatë inspektimit, nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë, P.Z, me detyrë Zv/Kryetar, M.K, me detyrë specialiste për kontrollin e dokumenteve dhe T.F, me detyrë jurist, u deklarua se: *“Objekti i familjes B.V, pavarësisht se deri më tani nuk është shpronësuar, për arsye të mosplotësisimit të dosjes, përsëri në vitin në vijim do kalojë në procesin e shpronësimit, pasi duhet të përfundojë projekti i plotë i Unazës Pogradec. Ndërkohë për të rregulluar gjendjen e lagështirës së objektit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së familjes B.V, bashkia në bashkëpunim me një firmë ndërtimi ka ndërhyrë në çatinë e objektit duke e riparuar atë. Bashkia duke parë gjendjen e vështirë të B.V, është e gatshme ta përfshijë në programet sociale të strehimit, me bonus qeraje. Procesi i shpronësimit të familjes B.V nuk ka përfunduar për arsyet që janë bërë të njohura nëpërmjet komunikimit shkresor, por në të njëjtat kushte janë dhe familjet e tjera që janë në të njëjtën ndërtesë si B.V, dhe për ato familje nuk ka përfunduar procesi i shpronësimit. Lidhur me mospërfshirjen e banesës së B.V në projektin e “Përmirësimin të banesave për familjet e varfëra”, informohet se duke qenë se procesi i shpronësimit kishte filluar, nuk mund të miratohej investimi në përmirësimin e banesës së B.V dhe të familjeve të tjera që jetojnë në të njëjtin pallat. Projekti i përmirësimin të banesave është zbatuar vetëm në banesat që kishin nevojë dhe që nuk ishin në proces shpronësimi”.*

Me shkresën nr. 4230/1, datë 15.10.2021, të protokolluar me tonën nr. 1270/2, datë 20.10.2021, Bashkia Pogradec në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga ana e Bashkisë Pogradec kërkesa për shpronësim për objektin “Sistemim asfaltim i aksit rrugor “Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec” është bërë në mbështetje dhe konform ligjit 8561/1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, të ndryshuar, si dhe sipas kërkesave dhe korrespondencave të kërkuara nga MIE. Së dyti, për vazhdimin e procedurave për shpronësim, Bashkia Pogradec ka kërkuar në mënyrë të përsëritur dhe me shkresa zyrtare, Fondit Shqiptar të Zhvillimit planimetrinë përfundimtare të shpronësimit të pasurive të paluajtshme për objektin në fjalë. Për këtë fakt është vënë në dijeni dhe MIE me shkresat: nr. 190/I, datë 02.03.2020 dhe nr. 834/2, datë 03.06.2021. Për sa më sipër objekti “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec” ka përfunduar (është kolauduar dhe është marrë në dorëzim). Lidhur me objektin e shtetasit B.V, zbatimi i projektit nuk e ka cënuar këtë objekt. Gjithashtu, nga ana e bashkisë janë kryer punime në objektin e B.V, duke bërë të mundur krijimin e kushteve më të mira të jetesës”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose*

bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Ankuesi B.V, me shkresën nr. 3096/10, datë 10.10.2018 të MIE-s është njoftuar për shpronësimin e pronës së tij, e cila prekej nga realizimi i projektit *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”*. Ankuesi pretendon se kanë kaluar 3 vjet nga njoftimi dhe akoma nuk është shpronësuar, gjë e cila e ka penguar për të rikonstruktuar shtëpinë dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës.

Referuar shkurtimisht kronologjisë së procesit të shpronësimit për interes publik të pasurive të palujtëshme, pronë private që preken nga zbatimi i projektit *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”*, rezulton se nga ana e institucioneve kanë dalë shkresat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 4112, datë 20.11.2017, drejtuar MIE-s, Bashkia Pogradec ka bërë kërkesën për shpronësim në interes publik për objektet “ndërtesë”, për pasuritë në emër të shtetasve: 1. V.M, 2. A.H, 3. M.Gj, 4. Pasuria nr. 17/127, ndërtesë 2 katëshe me 3 pronarë të ndryshëm; B.V, G.T dhe A.F, 5. Pasuria 15/103, ndërtesë me 4 bashkëpronarë; A.B, L.B, A.B dhe D.B, 6. M.Gj.

- Me shkresën nr. 4654/1, datë 01.12.2017, drejtuar Bashkisë Pogradec, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, i MIE-s pas verifikimit të dokumentacionit të dërguar, ka kërkuar sqarime dhe plotësim dokumentacioni, nga ana e bashkisë.
- Me shkresën nr. 591, datë 13.02.2018, drejtuar MIE-s, Bashkia Pogradec ka plotësuar dokumentacionin dhe ka bërë përsëri kërkesën për shpronësim në interes publik për objektet “ndërtesë”, për pasuritë në emër të shtetasve: 1. V.M, 2. A.H, 3. M.Gj, 4. Pasuria nr. 17/127, ndërtesë 2 katëshe me 3 pronarë të ndryshëm; B.V, G.T dhe A.F, 5. Pasuria 15/103, ndërtesë me 4 bashkëpronarë; A.B, L.B, A.B dhe D.B, 6. M.Gj.
- Me shkresën nr. 3096/1, datë 21.06.2018, drejtuar Bashkisë Pogradec, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, i MIE-s pas verifikimit të dokumentacionit të dërguar, ka konstatuar përsëri mangësi dhe ka kërkuar plotësim dokumentacioni, nga ana e bashkisë.
- Me shkresën nr. 591/3, datë 13.07.2018, drejtuar MIE-s, Bashkia Pogradec ka plotësuar dokumentacionin dhe ka bërë përsëri kërkesën për shpronësim në interes publik për objektet “ndërtesë”, për pasuritë në emër të shtetasve: 1. V.M, 2. A.H, 3. M.Gj, 4. Pasuria nr. 17/127, ndërtesë 2 katëshe me 3 pronarë të ndryshëm; B.V, G.T dhe A.F, 5. Pasuria 15/103, ndërtesë me 4 bashkëpronarë; A.B, L.B, A.B dhe D.B, 6. M.Gj.
- Me shkresën nr. 3096/10, datë 10.10.2018 të MIE-s, B.V është njoftuar se do të shpronësohej për pasurinë e paluajtshme, pronë private, si më poshtë: - Zonë kadastrale nr. 8582, numër pasurie 17/127+1-2/3 sipas hartës së regjistrimit; - Tokë truall me sipërfaqe $11.7 \text{ m}^2 \times 10491=122.745$ lekë; - Ndërtesë me sipërfaqe $46.8 \text{ m}^2 \times 49900=2.335.320$ lekë; Vlera paraprake e shpronësimit është= $2.458.065$ lekë.
- Në datë 10.10.2018, është lidhur Akt-Marrëveshja, mes MIE dhe Bashkisë Pogradec për shpronësimin për interes publik, të pasurive të palujtëshme, në pronësi private të cilat preken nga projekti “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”, në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 79, datë 11.10.2017, i ndryshuar me Urdhrit e Ministrit nr. 54, datë 19.01.2018 të MIE.
- Me shkresën nr. 6937/1, datë 07.11.2018, Bashkia Pogradec ka paraqitur pranë MIE-s një kërkesë të re, me lëndë: “Plotësim kerkese për shpronësim në interes publik në vazhdimësi “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”, për objektin “truall”.
- Në vijim të korrespondencës nga MIE është kërkuar plotësimi i dokumentacionit me shkresat si vijon: nr. 1425, datë 01.02.2019 “Kthim përgjigje”; nr. 2459/2, datë 10.05.2019 “Plotësim dokumentacioni”; nr. 1425/2, datë 28.05.2019 “Kthim përgjigje”; nr. 1425/3, datë 08.10.2019 “Mbi plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim”; nr. 2459/5, datë 30.12.2019 “Plotësim dokumentacioni”; nr. 4189, datë 03.06.2020 “Kthim përgjigje”; nr. 4189/2, datë 10.09.2020 “Kthim përgjigje” dhe nr. 1750, datë 12.02.2021 “Plotësim dokumentacioni”.
- Ndërkohë, nga Bashkia Pogradec është plotësuar dokumentacioni i dosjes me shkresat si vijon: nr. 956/3, datë 26.03.2019 “Plotësim dokumentacioni”; nr. 956/7,

datë 14.11.2019 “Plotësim dokumentacioni”, dhe nr. 2481/1, datë 07.07.2020 “Plotësim dokumentacioni”.

- Njëkohësisht Bashkia Pogradec, në vijimësi i është drejtuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me shkresat nr. 190, datë 14.01.2020, nr. 190/1, datë 02.03.2020 dhe nr. 190/3, datë 10.03.2020, në të cilat i ka kërkuar projektin e plotë të shpronësimeve sipas projektit të zbatuar.
- Me shkresën nr. 4511, datë 31.05.2021, drejtuar Bashkisë Pogradec, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, ka kthyer dosjen e shpronësimit, pasi ka konstatuar mangësi.
- Në përfundim, me shkresën nr. 320, datë 23.07.2021 drejtuar Bashkisë Pogradec, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, ka informuar bashkinë se: *“Pranë MIE rezultojnë tre kërkesa të ndryshme për shpronësim nga Bashkia Pogradec, për të njëjtin projekt. Ndodhur në këto kushte, nga subjekti kërkues duhet të vijë një kërkesë për shpronësim, ku të jenë të përfshira të gjitha pasuritë, pronë e paluajtshme që preken nga realizimi i projektit “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Rruga Unazë””*.

Referuar Akt-Kolaudimit datë 30.11.2018, të objektit: *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Rruga Unazë”*, rezulton se punimet për këtë projekt kanë filluar në datë 29.05.2017 dhe kanë përfunduar në datë 03.10.2018, dhe palët⁸ (Bashkia Pogradec, FSHZH dhe Kontraktori) kanë rënë dakord për marrjen në dorëzim të objektit në datë 03.12.2018.

Shpronësimi i pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme, pronë private për interesa publike është një proces që rregullohet nëpërmjet dispozitave të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”*, të ndryshuar. Duke pasur parasysh që procedura për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga zbatimi i projektit *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Unaza Pogradec”*, ka filluar në vitin 2017, Komisioneri do i referohet ligjit të sipërcituar, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 20/2016, datë 10.03.2016.

Në nenin 5, pika 1, të këtij ligji parashikohet se: *“Kur realizimi ose mbrojtja e interesave publike nuk mund të arrihet pa ushtruar të drejtat e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme ose të luajtshme pronë private, Këshilli i Ministrave, mbi kërkesën e subjektit kërkues në favor të të cilit bëhet shpronësimi, me propozim të ministrit kompetent sipas këtij ligji, vendos shpronësimin e këtyre pasurive.”* Objekte të shpronësimit⁹ janë pasuritë e paluajtshme në formën e tokës, të ndërtimeve të çdo lloji me karakter të përhershëm, si dhe pasuritë e luajtshme të treguara në shkronjat “e” dhe “ë” të nenit 8 të këtij ligji. Sipas nenit 9, të ligjit të sipërcituar, shpronësimi mund të bëhet në favor të shtetit dhe të personave juridikë publikë ose privatë, vendas ose të huaj, për realizimin nga ana e tyre të një projekti, investimi apo objekti që, në çdo rast në përputhje me këtë ligj, paraqet interes publik.

⁸ Referuar Çertifikatës së Përfundimit të Punimeve të supervizorit datë 03.12.2018.

⁹ Referuar nenit 7 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”*, të ndryshuar.

Gjatë analizimit të akteve të depozituara në cilësi prove, Komisioneri konstatoi se kërkesa për shpronësim e Bashkisë Pogradec është bërë në mbështetje të bazës ligjore, të mëposhtëme:

Neni 8, gërma ç), të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për këto shkaqe: ç) Për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut”.

Neni 10, pika 1, të ligjit të sipërcituar, parashikohet se: “Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë kompetente sipas ligjit, kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: a) Aktet që vërtetojnë cilësinë dhe regjistrimin e tij si person juridik. b) Projektet e nevojshme dhe të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik, lidhur me realizimin e këtyre projekteve. c) Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit. ç) Vlerësimi paraprak i objekteve të shpronësimit dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat. d) Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet. dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse. e) Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës. ë) Dokumentet që vërtetojnë shkakun e shpronësimit, sipas nenit 8 të këtij ligji”.

Neni 11, të të njëjtit ligj, parashikohet shprehimisht se: “1. Kërkesat për shpronësim paraqiten në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, ndërsa propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim, bëhet nga ministri përkatës. 2. Me paraqitjen e kërkesës për shpronësim për interes publik, ministri kompetent urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit”.

Neni 12, të ligjit, parashikohet se:

1. *Ministria kompetente kryen verifikimet e nevojshme për subjektin kërkuar, në favor të të cilit kërkohet shpronësimi, për dokumentacionin e paraqitur, për shkakun e shpronësimit, si dhe administron aktet e pronësisë për objektet e shpronësimit, duke kryer, nëse është e nevojshme, edhe verifikime në vend.*
2. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ministria kompetente i kthen menjëherë pa veprim kërkuarit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij sipas këtij neni, duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.

3. Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ministria dhe i njoftohet menjëherë kërkuarit të shpronësimit.
4. Kërkuari i shpronësimit ka të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 13, të ligjit, parashikohet se:

1. Në përfundim të verifikimeve të nevojshme, si dhe të procedurave të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues përkatës janë të mbështetur në kushtet dhe kriteret e këtij ligji, ministria kompetente vendos për pranimin e kërkesës për shpronësim, duke njoftuar menjëherë me shkrim subjektin kërkuar në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësimi.
2. Brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të pranimit të kërkesës për shpronësim ndërmjet subjektit kërkuar në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësim dhe ministrisë kompetente, lidhet një marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella, lidhur me procedurën e shpronësimit. Në rastin e kërkuarit subjekt privat kjo marrëveshje bëhet me akt noterial.

Në vijim të nenit 11 të sipërcituar, mbështetur në nenin 14¹⁰, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar, si dhe pikës 3, të Vendimi nr. 126, datë 23.03.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen dhe procedurat e punës së Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i është drejtuar ankuesit me shkresën “Njoftim për shpronësim publik”, nëpërmjet të cilës subjekti që do të shpronësohet, njoftohet mbi shpronësimin e pasurisë përkatëse, që rezulton në pronësi të tij, sipërfaqen e shpronësimit dhe vlerën totale të shpronësimit.

Gjithashtu, rezulton se B.V dhe pronarët e tjerë pjesë e listës së shpronësimit kanë rënë dakord me vlerësimin e pronës për shpronësim, pasi nuk e kanë kundërshtuar, sipas përcaktimit të nenit 15/2 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar.

Nga analizimi i fakteve dhe legjislacionit të sipërcituar, rezulton se në përfundim të verifikimeve, MIE ka pranuar si të mbështetur në kushtet dhe kriteret e ligjit, kërkesën për shpronësim të bërë nga Bashkia Pogradec me shkresën nr. 591/3, datë 13.07.2018. MIE dhe Bashkia Pogradec, duke qenë se kanë vlerësuar se kërkesa është e plotësuar dhe brenda kushteve ligjore, kanë bërë dhe

¹⁰ Neni 14, i ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar parashikohet : 1. Ministria kompetente, brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkuar të shpronësimit, fillon përmbushjen e procedurave të njoftimit të drejtpërdrejtë të secilit pronar a bashkëpronar të pasurive pronë private që kërkohet të shpronësohen ose zhvlerësohen, si dhe personave të tretë lidhur me kompensimin e tyre. Së bashku me procedurat e njoftimit, ministri kompetent realizon edhe ato të publikimit të kërkesës për shpronësim për interes publik. 2. Rregullat e hollësishme për mënyrën e njoftimit, përmbajtjen e tij dhe procedurat përkatëse caktohen me akt normativ të Këshillit të Ministrave.”

procesin e njoftimit të pronarëve që prekeshin nga ky projekt, si dhe kanë lidhur mes tyre Akt-Marrëveshjen me detyrimet përkatëse. Pra, rezulton se në datë 10.10.2018, kur është bërë dhe njoftimi i B.V, dhe është botuar kërkesa për shpronësim në Fletoren Zyrtare nr. 145, datë 11.10.2018, MIE dhe Bashkia Pogradec kanë vlerësuar se kërkesa dhe dosja për shpronësim ka qenë e rregullt.

Gjithashtu, rezulton se pas pranimit të kërkesës për shpronësim, mes MIE-s dhe Bashkisë Pogradec janë shkëmbyer disa shkresa lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim, gjë që ka bërë që kërkesa për shpronësim të mos miratohet dhe ankuesi të mospërfitojë vlerën e shpronësimit të njoftuar që në datë 10.10.2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ankuesi për shkak të lagështirës dhe amortizimit të banesës, me shkresën datë 22.10.2020, të protokolluar pranë bashkisë me nr. 5276, i është drejtuar bashkisë, duke i kërkuar rikonstruktimin e banesës, në kuadër të projektit të rindërtimit të bllokut të banesave.

Bashkia Pogradec me shkresën nr. 5276/1, datë 12.11.2020, drejtuar ankuesit i ka parashtruar se: *“Nga verifikimi i bërë nga specialistët e Emergjencave Civile dhe dokumentacionit që disponon Bashkia Pogradec, rezulton se banesa është pjesë e projektit të shpronësimeve të objektit “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Rruga Unazë”*”. Kjo ka qenë dhe arsyeja që Bashkia Pogradec nuk ka bërë rikonstruksionin e apartamentit të ankuesit.

Nga shqyrtimi i dokumenteve, rezulton se dosja me kërkesat për shpronësim për objektin: *“Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Rruga Unazë”*, është kthyer për plotësim nga ana e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet dhe akoma nuk ka një afat se kur mund të bëhet shpronësimi për pronën e B.V, pasi nga Bashkia Pogradec akoma nuk është dorëzuar dokumentacioni i plotë dhe kërkesa për shpronësim në ASHSH për projektin në fjalë. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të shqyrtuar, MIE dhe Bashkia Pogradec nuk kanë të planifikuar fonde për shpronësimin e pronarëve për projektin në fjalë, për vitin 2021.

Zvarritja e kryerjes së procesit të shpronësimit, nga viti 2017 kur kanë filluar punimet dhe në vijim është tej çdo afati të parashikuar¹¹ në Akt-Marrëveshjen e lidhur mes MIE-s dhe Bashkisë Pogradec. Kjo vonesë nga ana e MIE-s dhe Bashkisë Pogradec, prej një periudhe për më shumë se 3 vitesh është bërë shkak për mosrikonstruksionin e banesës së ankuesit, duke e lënë atë dhe familjarët e tij, në kushte banimi të papërshtatshme.

Bashkia Pogradec ka qenë plotësisht në dijeni të thelbit të kërkesës për rikonstruksion të banesës së ankuesit dhe qëllimit për të cilin ai ka kërkuar rikonstruktimit e banesës, si dhe ka qenë në dijeni të vonesave të kërkesave për shpronësim dhe që nuk ka pasur fonde në dispozicion për

¹¹ Referuar, detyrimin të Bashkisë Pogradec të përcaktuar në Akt-Marrëveshjen të lidhur mes MIE-s dhe Bashkisë, parashikohet se: *“Bashkia Pogradec, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së përgjigjes nga i njoftuari dhe jo më përpara se 1 muaj, nga data e fundit të afatit të publikimit të për kalimin e pronësisë në favor të shtetit, kundrejt shpërblimit apo pagesës së masës së kompensimit për zhvlerësimin e pasurisë pronë private”*. kërkesës për shpronësim për interes publik, në rastet kur të njoftuarit kanë pranuar kushtet mes palëve, kryen me të njoftuarit veprimet

shpronësim dhe përsëri nuk ka bërë asnjë përpjekje për të rregulluar kushtet e banimit për familjen B.V.

Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga Bashkia Pogradec.

Në nenin 11, pika 1, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kërkesa për shpronësim paraqitet në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, ndërsa propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim, bëhet nga ministri përkatës”.

Referuar neneve 20-21 të ligjit të sipërcituar, rezulton se me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, ministri kompetent i paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe në vijim Këshilli i Ministrave vendos mbi shpronësimin në rastet kur propozimi për shpronësim gjendet i bazuar në ligj dhe në fakte.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka propozuar në Këshillin e Ministrave, kërkesën për shpronësim, lidhur me objektin “Sistemim asfaltim i aksit rrugor Qafë Plloçë-Hyrja Pogradec dhe Rruga Unazë”, kështu që në këtë rast, Këshilli i Ministrave nuk kishte, se si të miratonte një akt, i cili nuk i kishte vajtur për miratim.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2 , të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Në ankesë, pretendohet diskriminim për shkak të “etnisë”, “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shëndetësore” nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Pogradec.

“Etnia”, “gjendja ekonomike” dhe “gjendja shëndetësore” janë shkaqe, për të cilat, ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “etnisë”, Komisioneri vlerëson se “etnia” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme¹², që provojnë se ankuesi e mbart këtë shkak.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike dhe shëndetësore”, Komisioneri gjykon se “gjendja ekonomike dhe shëndetësore” konsiderohen si shkaqe të mbrojtura, pasi jo vetëm parashikohen si të tilla në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova¹³ që provojnë se ankuesi i mbart këto shkaqe.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 41 të Kushtetutës, dispozitë kjo që garanton të drejtën e pronës.

Neni 1, i Protokollit Nr. 1, të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën e pronës, duke sanksionuar se, çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij.

MIE dhe Bashkia Pogradec, nëpërmjet veprimeve të tyre, duke mosrealizuar procesin e shpronësimit dhe si rezultat duke bllokuar të gjitha veprimet që mund të kryente ankuesi me proën e tij, ka cënuar të drejtën e ankuesit për të rikonstruktuar banesën e tij.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkuftizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me

¹² Referuar Vërtetimit datë 14.06.2021 të Shoqatës “Qëndistarët”, B.V është anëtar i komunitetit egjiptian.

¹³ Referuar Vërtetimit datë 11.06.2021 të Bashkisë Pogradec, Sh.V (motra) dhe B.V trajtohen me ndihmë ekonomike si persona me aftësi të kufizuara, ndërsa A.V (bashkëshortja) trajtohet me ndihmë ekonomike si kujdestare e Sh.V.

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Referuar nenit 3, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyre të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit”.

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

- a) *duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) *duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin.
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më tepër se një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Bazuar në nenin 33, pika 7/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jenë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁴

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ai i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm.

Ankuesi pretendon se, trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm, të cilit i është nënshtruar, ka si bazë më shumë se një shkak dhe konkretisht, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike dhe shëndetësore, pasi nuk është kryer procesi i shpronësimit dhe si rezultat nuk i është bërë dhe rikonstruktimi i banesës, për shkak se i përket komunitetit egjiptian dhe trajtohet me KMCA. Referuar pretendimeve të parashtruara nga ankuesi, rezulton se etnia e ankuesit dhe gjendja ekonomike dhe shëndetësore e tij dhe familjes së tij, janë të ndërlidhura dhe bashkëveprojnë me njëra në të njëjtën kohë për të prodhuar sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ankuesi.

Mirëpo, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, ankuesi nuk arriti të provojë dhe dokumentojnë se shkaqet e pretenduara prej tij kanë shërbyer si shkaqe për të cilin ai është diskriminuar nga ana e MIE-s dhe Bashkisë Pogradec. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijimësi, si me email-in datë 22.06.2021 dhe gjatë seancës dëgjimore kërkoi nga ankuesi informacion nëse kishte dijeni për persona të tjerë që ishin në proces shpronësimi dhe Bashkia Pogradec kishte kryer rikonstruktimin e banesës së tyre. Subjekti ankues nuk arriti të identifikonte persona të tjerë që nuk mbartnin shkaqet e pretenduara nga ankuesi, por që ishin trajtuar ndryshe nga MIE dhe Bashkia Pogradec.

Në shqyrtim të kërkesës për shpronësim, objekt i ankesës, rezulton se në këtë kërkesë për shpronësim janë përfshirë 6 pasuri të ndryshme, ndër të cilat katër pasuri janë me përshkrimin truall dhe objekte dhe dy pasuri janë ndërtesë, të cilat janë në bashkëpronësi. Referuar pasurisë objekt shqyrtimi, rezulton se është një pallat i vjetër dy katësh dhe hyrjet në krahun e djathtë të ndërtesës janë në pronësi të tre personave të ndryshëm me sipërfaqe si më poshtë: B.V 46.8 m², G.T 21 m² dhe A.K 67.8 m².

Referuar dokumentacionit të analizuar dhe në përgjigjen dërguar Komisionerit nga ASHSH dhe Bashkia Pogradec, rezulton se procesi i shpronësimit nuk ka përfunduar jo vetëm për ankuesin, por për asnjë nga pronarët e prekur nga ky projekt.

¹⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Gjithashtu, Bashkia Pogradec nuk mund të kryente punime të rikonstruksionit me fonde publike në kuadër të projektit “Për pëmirësim të banesave për familjet e varfëra”, jo vetëm të banesës së ankuesit por dhe të personave të tjerë, në kohën kur kishte dijeni që në vitin 2017, që pronat e tre banorëve të pallatit ishin planifikuar për tu shpronësuar.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, qenia e ankuesit që i përket komunitetit egjiptian dhe si invalid pune i cili trajtohet me ndihmë ekonomike, nuk mund të ketë shërbyer si shkak për trajtimin e tij të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e MIE-s dhe Bashkisë Pogradec.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pavarësisht konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm ndaj ankuesit nga ana e MIE dhe Bashkisë Pogradec, lidhur me vonesën e procesit të shpronësimit dhe moskonstruktimit të banesës dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar subjekti ankues, është si rezultat i posedimit të këtij shkakut, dhe se në mungesë të tij, ankuesi do të ishte trajtuar ndryshe.

Referuar standartit të provës të parashikuar nga neni 33, pika 7/1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u arritën të administroheshin fakte dhe prova mbi bazën e të cilave mund të prezumohet se ka patur sjellje diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, MIE dhe Bashkia Pogradec nuk mund të ngarkohen me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi nuk përbën diskriminim.

Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t’u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Përsa kohë rezulton e provuar se, procesi i shpronësimit nuk është bërë për asnjë person të listës së shpronësimit dhe rikonstruktimit i banesës nuk është bërë për asnjë person që është në proces shpronësimi, Komisioneri vlerëson se sjellja e MIE-s dhe Bashkisë Pogradec ndaj ankuesit mbetet në kuadër paligjshmërie, por nuk provohet që ajo të jetë motivuar nga shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjekti ankues me pretendimin për diskriminim, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike dhe shëndetësore”, është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që MIE dhe Bashkia Pogradec të ketë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të B.V, për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike dhe shëndetësore, nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Pogradec.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA